

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 101 të Kushtetutës së RMV, të nenit 37 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit të gjykatave (Gazeta zyrtare e RMV” nr.58/06, 35/08, 150/10, 39/12, 83/18, 198/18, 96/19), nenit 59 paragrafi 2 dhe nenit 69 të Rregullores së punës të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme më 28.04.2021, miratoi:

QËNDRIM PARIMOR

1. Kur me vendimmarrjen e lëndës konkrete, gjyqtarit referues – anëtarë i këshillit i ndërpritet ose është shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit, ndërsa vendimi i lëndës është përpunuar me shkrim dhe është nënshkruar apo është nënshkruar procesverbalit për këshillim dhe votim, lënda do të dorëzohet në sportelin gjyqësor për procedim të mëtejshëm.

2. Në rast të ndërprerjes ose shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit të një anëtari të këshillit pas vendimmarrjes së lëndës konkrete, lënda me vendim të përpunuar me shkrim, e nënshkruar nga kryetari i këshillit dhe anëtarët tjerë, apo të nënshkruarit e procesverbalit për këshillim dhe votim pa nënshkrimin e tij do të dorëzohet në sportelin gjyqësor për procedim të mëtejshëm.

3. Kur vendimi i përpunuar me shkrim, i nënshkruar nga gjyqtari referues, të cilit i është ndërprerë apo është shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit, ka mangësi apo gabime gjatë shkrimit, të njëjtat do të mënjanohet kryetari i këshillit dhe pa nënshkrimin e gjyqtarit referues do të dorëzohet në sportelin gjyqësor për procedim të mëtejshëm.

4. Kur kryetari apo anëtari i këshillit nuk pajtohet me arsyetimin e vendimit të përpunuar me shkrim nga gjyqtari referues, të cilit i është ndërprerë apo është shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit, kryetari me anëtarët tjerë të këshillit do të vendosin me çfarë arsytimi do të jetë vendimi, ndërsa për nënshkrimin e të njëjtit, pa nënshkrimin e gjyqtarit referues do të dorëzohet në sportelin gjyqësor për procedim të mëtejshëm.

5. Kur kryetari i këshillit apo anëtarë i këshillit me shkaqe arsyetuese, të argumentuara dhe të qëndrueshme kërkon përsëri që të shqyrtohet për një lëndë konkrete (rivotim), ndërsa gjyqtarit referues si anëtarë i këshillit ndërkohë i është ndërprerë apo është shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit, do të realizohet përsëri shpërndarja automatike e lëndës dhe do të shqyrtohet lënda para kryetarit dhe anëtarëve tjerë të këshillit të njëjtë.

6. Në rast të ndërprerjes apo shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit, gjyqtarit referues si anëtarë i këshillit pas vendimmarrjes së lëndës konkrete, ndërsa vendimi nuk është përpunuar me shkrim, kryetari i këshillit do të organizojë që të përpunohet vendimi, ndërsa pas nënshkrimit të së njëjtit nga kryetari i këshillit dhe anëtarët tjerë, pa nënshkrimin e gjyqtarit referues do të dorëzohet në sportelin gjyqësor.

7. Në rast të ndërprerjes apo shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit, të kryetarit të këshillit apo anëtarit të këshillit pas vendimmarrjes së lëndës konkrete, ndërsa pas përpunimit me shkrim të vendimit refuzon të njëjtën apo procesverbalin e këshillimit dhe votimit refuzon ti nënshkruajë për shkaqe të paarsyeshme, pas nënshkrimit të vendimit apo procesverbalit për këshillim dhe votim nga anëtarët tjerë të këshillit lënda me rezolucion të kryetarit apo zëvendësit të kryetarit të sektorit përkatës, do të dorëzohet në sportelin gjyqësor për procedim të mëtejme.

8. Në rast të ndërprerjes apo shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit, kryetarit të këshillit apo anëtarit të këshillit, lëndët të cilat janë të referuara, ndërsa për të cilat nuk është miratuar vendim, do të ri referohen në të njëjtën përbërje, para kryetarit dhe anëtarit të këshillit, të cilët zëvendësohen sipas Orarit vjetor të punës së gjyqtarëve dhe të administratës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që ka vlejtur në kohën e referimit të lëndës.

9. Kur lënda është referuar nga gjyqtari referues, ndërsa ende nuk është miratuar vendim, pas ndërprerjes apo shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit, të gjyqtarit referues, do të realizohet shpërndarja automatike e lëndës, gjyqtari të cilit do t'i shpërndahet lënda do ta referojë lëndën para këshillit të njëjtë, sipas Orarit vjetor të punës së gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore, të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut që ka vlejtur në kohën e referimit të lëndës.

10. Në rast të ndërprerjes apo shkarkimit nga funksioni i gjyqtarit, të gjyqtarit i cili është i obliguar me lëndët, ndërsa kjo lëndë është dorëzuar në sportelin gjyqësor sipas këtij qëndrimi parimor lënda konsiderohet si e vendosur dhe e shpallur si e përfunduar në sistemin e automatizuar kompjuterik, me verifikim nga ana e personit përgjegjës në sistemin e automatizuar kompjuterik.

A r s y e t i m

Kryetarja e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 37 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit të gjykatave më 05.04.2021 parashtrori iniciativë drejtuar Seancës së përgjithshme të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të miratojë qëndrim parimor lidhur me mënyrën e procedimit të lëndëve nga të gjitha sferat, për të cilat gjykata e përbërë nga këshilli, pas këshillimit dhe votimit ka miratuar vendim, ndërsa pastaj kryetari i këshillit apo anëtarit të këshillit i ndërpritet

funkcioni i gjyqtarit sipas nenit 73 të Ligjit të gjykatave ("Gazeta zyrtare e RMV" nr.58/06, 35/08, 150/10, 39/12, 83/18, 198/18, 96/19) apo është shkarkuar sipas nenit 74 të këtij Ligji.

Kjo për arsye se, në punën e përditshme jo vetëm në Gjykatën supreme të RMV, por edhe në gjykatat tjera është prezentë çështja se si të veprohet me lëndët, për të cilat pas vendimmarrjes së lëndëve, kryetarit të këshillit apo anëtarit të këshillit i ndërpritet funksioni i gjyqtarit apo është shkarkuar në situatën kur:

1. Gjyqtari referues e ka përgatitur dhe e ka nënshkruar vendimin.
2. Vendimi i përgatitur dhe i nënshkruar nga gjyqtari referues ka mangësi apo gabime të dukshme që imponohet nevoja për tu korigjuar.
3. Kur kryetari apo anëtarë i këshillit nuk pajtohet me arsyetimin e vendimit.
4. Kur kryetari i këshillit apo anëtarë i këshillit ma shkaqe të arsyeshme dhe të pranueshme kërkon që përsëri të shqyrtohet për lëndën (rivotim).
5. Vendimi i miratuar nuk është përgatitur nga gjyqtari referues, procesverbali për këshillim dhe votim nuk është nënshkruar nga ai, ndërsa është nënshkruar nga kryetari i këshillit dhe anëtarëve tjerë të këshillit
6. Nga shkaqe të paarsyeshme vendimi i përgatitur dhe i miratuar apo procesverbali për këshillim dhe votim nuk nënshkruhet nga kryetari apo nga anëtarë i këshillit i cili është aktual, i shkarkuar apo i është ndërprerë funksioni.
7. Si dhe kush do të realizojë verifikimin me dorëzimin e lëndës në sportelin gjyqësor.
8. Si të veprohet edhe me lëndët, të cilat janë referuar por është prolonguar miratimi i vendimit.

Çështjet e tilla nuk janë të rregulluara me Ligjin e gjykatave, me ligjet procedurale nga sfera civile dhe penale, me Rregulloren gjyqësore, por as edhe me Rregulloren e punës së Gjykatës supreme të RMV, respektivisht bëhet fjalë për zbrazëtitë juridike.

Megjithatë, duke qenë se bëhet fjalë për çështje me kuptim të përgjithshëm të punës së tërë gjyqësisë, ndërsa në interes të avancimit të metodës së punës së gjykatave, sigurimin e madh të efikasitetit në punën e gjykatave edhe krahas faktit që në mënyrë eksplicite të njëjtat nuk janë të rregulluara me ligjshmërinë ekzistuese, nuk do të thotë se në vendimmarrjen e të njëjtëve duhet të qaset në mënyrë arbitrare, por përkundrazi, çështjet e këtilla meritojnë qasje serioze dhe studiuare për vendosje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës duke u nisur nga mënyra e përpilimit të procesverbalit për këshillim dhe votim, përpunimin me shkrim dhe miratimin e vendimit, të rregulluara me ligje procedurale nga sfera civile dhe penale, si dhe nga Rregullorja gjyqësore (Gazeta zyrtare e RMV 66/13, 114/14).

Me iniciativë të parashtruar, Seanca e përgjithshme e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 07.04.2021 njëzëri e miratoi konkluzionin me të cilin u pranua iniciativa, dhe si gjyqtar referues për përgatitjen e planit të qëndrimit parimor u përcaktua gjyqtari Shpend Devaja.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 28.04.2021, pas diskutimit për propozim planin e qëndrimit parimor, sipas nenit 37 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit të gjykatave, e miratoi qëndrimin propozuar parimor.

**SEANCA E PËRGJITHSHME E
GJYKATËS SUPREME TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**